



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**

**PËR**

**MONITORIMIN E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT NË**

**KRYEMINISTRI**

**Tiranë, Shtator 2018**

## RAPORT

### **Për përmbylljen e procesit të monitorimit në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të ristrukturimit, në Kryeministri**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet urdhrinr. 85, datë 9.10.2017, “Për fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave”, ka vendosur fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës.

Bazuar në pikën 1, të tabelës nr. 1, bashkëlidhur urdhrin më sipër, u ngrit grupi i punës me përbërje inspektorët, Valentina Kolleshi dhe Aida Dobjani, të cilët janë autorizuar nga Komisioneri për të monitoruar procesin e ristrukturimit në Kryeministri, i cili filloi në datën 5.2.2018.

Objekti i monitorimit në këtë institucion është procedura e ristrukturimit, që përfshin të gjitha proceset e legjislacionit për nëpunësin civil, që rregullojnë këtë aspekt, ndër të cilat përmendim, hartimin e përshkrimeve të reja të punës; krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit, aktet administrative për propozimin e transferimeve të Komisionit të Ristrukturimit; verifikimi i propozimeve për sistemimin e nëpunësve dhe miratimi i tyre nga Departamenti i Administratës Publike; evidentimi i rasteve të lirimit nga shërbimi civil, respektimi i afateve procedurale nga ana e aktorëve që marrin pjesë në këtë procedurë, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës përpunoi të dhënat dhe përgatiti raportin e monitorimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit në Kryeministri, si më poshtë:

#### **Qëllimi i monitorimit**

Qëllimi i realizimit të këtij procesi është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe

*kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.*

- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e procesit të ristrukturimit.
- Paralajmërimin e njësisë përgjegjëse, institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Metodologjia e monitorimit**

Si metodë pune është përdorur verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në sektorin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si dhe Departamentit të Administratës Publike. Konkretisht, grupi i punës realizoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u organizua një takim dhe bashkëbisedim, me \*\*\*\*\*, me detyrë “Kordinatorë”, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm, e komanduar për kryerjen e detyrës së Drejtorit të Departamentit të Burimeve, Transparencës dhe Administrimit, (pasi ky pozicion vazhdon të jetë i lirë), me të cilën u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e procesit, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të punës për verifikim. Person i kontaktit me grupin e punës në këtë institucion, u caktua nëpunësja \*\*\*\*\*, e cila kryen detyrën e “Specialistit”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Administrimit.
- U administrua gjithë dokumentacioni shkresor i konsideruar i nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi, e konkretisht: struktura aktuale dhe struktura mëparshme; listëprezencat para dhe pas ristrukturimit; disa modele të formatit të përshkimeve të punës; dokumentacioni që materializon procedurën e ristrukturimit; aktet administrative që materializojnë vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe të Departamentit të Administratës Publike; si dhe çdo dokumentacion tjetër që ndihmon realizimin e verifikimit të procesit.

### **Përmbajtja e Raportit:**

Me dekretin nr. 10604, datë 10.9.2017, të Presidentit të Republikës, është emëruar Këshilli i Ministrave, i cili në ndryshim nga ai paraardhësi, rezulton se ministritë e linjës janë shkurtuar nga 16 në 11, pra, numri i tyre është reduktuar me 5. Kjo ka çuar edhe në shkurtim të numrit të pozicioneve të punës.

Gjithashtu, ndryshimi i kabinetit qeveritar, është shoqëruar edhe me ndryshime thelbësore të brendshme të institucioneve në misionin që kanë dhe për pasojë ka lindur domozdoshmëria e ristrukturimit të tyre.

Kriteret bazë mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit, janë parashikuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Kreu II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, si dhe Udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tyre, kanë dalë Urdhrat e Kryeministrit, për miratimin e strukturave dhe organikave të Kryeministrit dhe ministrive të linjës.

### **I. Analiza e ndryshimeve të Strukturës Organizative.**

Me Urdhrin nr. 176, datë 10.10.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Kryeministrit”, të Kryeministrit, është miratuar struktura aktuale e Kryeministrit e cila i shtrin efektet nga data 1.11.2017.

Nga verifikimi i tërësisë së materialeve shkresore të vëna në dispozicion, si dhe vlerësimit të tyre në raport me ligjin konstatohet se:

#### ➤ **Struktura para ristrukturimit**

Kryeministria, deri në fillimin e efekteve të strukturës së re, ka qenë e organizuar dhe funksiononte në bazë të strukturës së miratuar me urdhrin nr. 76, datë 29.5.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Kryeministrit”, i cili ka pësuar ndryshime me Urdhrin nr. 137, datë 15.9.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 76, datë 29.5.2015, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Kryeministrit”, të ndryshuar”.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, Kryeministria në këtë periudhë, ka pasur gjithsej **224** pozicione pune, nga të cilat, **133 pozicione pune vlerësohen pjesë e shërbimit civil**, kurse pjesa tjetër, ishin pozicione politike (Kabineti i Kryeministrit, Zv.kryeministrit, Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministër Shteti për Çështjet Vendore, Ministër Shteti për Inovacionin & Administratën Publike) dhe staf mbështetës, që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Duke analizuar këtë strukturë, vërehet se institucioni është i organizuar dhe funksionon me 6 departamente, që në përbërjen e vet, janë të organizuara në drejtori dhe sektorë. Pozicioni

më i lartë drejtues, është Sekretari i Përgjithshëm, në varësinë e të cilit janë këto struktura organizative, të cilat paraqiten si më poshtë:

- *Departamenti i Zhvillimit & Ndihmës së Huaj,*
- *Departamenti i Legjislacionit, Monitorimit të Programeve & Antikorrupsionit,*
- *Departamenti i Jetësimit të Prioriteteve,*
- *Departamenti i Komunikimit & Marrëdhënieve me Qytetarët,*
- *Departamenti i Administrimit & Shërbimeve,*
- *Departamenti i Inovacionit & Mirëqeverisjes.*

➤ **Struktura pas ristrukturimit**

Më tej, duke bërë një krahasim të kësaj strukture që sapo analizuam, me strukturën aktuale të miratuar me Urdhrin nr. 176, datë 10.10.2017, të Kryeministrit, konstatojmë se organizimi dhe funksionimi i Kryeministrit, tani paraqitet me 3 departamente, të cilat janë në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm dhe kanë të bëjnë me a) politikën dhe zhvillimin nën fushën e përgjegjësisë, b) aspektin rregullator dhe përputhshmërinë, si dhe, c) aspektin ekonomik dhe shërbimet mbështetëse, të cilat paraqiten si më poshtë:

- *Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes,(ish Departamenti i Zhvillimit & Ndihmës së Huaj),*
- *Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë,(ish Departamenti i Legjislacionit, Monitorimit të Programeve & Antikorrupsionit)*
- *Departamenti i Burimeve, Transparencës dhe Administrimit.(rikompozim i Departamenti i Administrimit & Shërbimeve),*

Me strukturën e re është shkurtuar:

- *Departamenti i Jetësimit të Prioriteteve,*
- *Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Qytetarët, (funksionet e Drejtorisë së Informacionit i kalojnë Drejtorisë së Monitorimit dhe Informacionit e cila i atashohet Agjencisë Telegrafike Shqiptare)*
- *Funksionet e Drejtorisë së IT, me miratimin e strukturës së re të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI), do të kryhen nga njësitë organizative të AKSHI-t, të dedikuara për menaxhimin e TIK në Kryeministri.*
- *Departamenti i Inovacionit & Mirëqeverisjes, nuk ekziston në strukturën e re. Funksionet e Njesisë së Komunikimit Elektronik, Postar dhe Integritimit, i atashohen fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.*
- *Funksionet e Sekretariatit Teknik (Drejtoria) i Sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Administrimit Publik, i janë atashuar funksioneve të Sektorit të Qeverisjes së Mirë*

dhe Jetësimit të Prioriteteve, në Departamentin e Administratës Publike dhe Departamentit të Zhvillimit të Mirëqeverisjes në Kryeministri.

Sipas kësaj strukture organizative, rezulton se Kryeministria ka gjithsej 150 pozicione pune nga të cilat, 78 pozicione pune vlerësohen pjesë e shërbimit civil, ndërsa pjesa tjetër, janë pozicione politike (*Kabineti i Kryeministrit, Zv.kryeministrit, Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministër Shteti për Diasporën*), si dhe staf mbështetës, që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Konstatohet se, gjatë procesit të ristrukturimit, janë sistemuar 57 nëpunës civilë, ndërsa 21 pozicione pune janë vende të lira (5 pozicione të nivelit të lartë drejtues-TND, 11 pozicione të nivelit të mesëm drejtues, 4 pozicione të nivelit të ulët drejtues dhe 1 pozicioni i nivelit ekzekutiv.)

Po të analizojmë klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr.262, datë 25.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil, paraqiten në këtë raport:

#### A.Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil, para ristrukturimit

- *Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese janë 26 pozicione pune,*
- *Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese janë 51 pozicione pune,*
- *Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese janë 13 pozicione pune,*
- *Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive janë 43 pozicione*

#### B.Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil, pas ristrukturimit

- *Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese janë 15 pozicione pune,*
- *Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese janë 39 pozicione pune,*
- *Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese janë 7 pozicione pune,*
- *Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive janë 17 pozicione pune.*

Mënyra e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil, sipas strukturës së re, krahasuar me strukturën e vjetër e detajuar, paraqitet si më poshtë:

Pozicionet e shërbimit civil sipas emërtesës	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së vjetër)	Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së re)
Pozicione TND	16	12
Drejtor	10	3
Koordinator/jurist (II-b)	44	39
Inspektor (II - b)	7	0
Koordinator (III-a)	5	2
Përgjegjës sektori	8	5
Specialist	43	17
<b>Nëpunës civil gjithsej</b>	<b>133</b>	<b>78</b>

Nga sa më sipër, konstatohet se struktura dhe organika e re e Kryeministrisë, rezulton të ketë sjellë jo vetëm reduktim të numrit të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil në të gjitha kategoritë, por, gjithashtu, në strukturën e re nuk ekziston emërtesa e pozicionit të punës, “*Inspektor*”, e cila klasifikohet në nivelin e mesëm drejtues.

**Konkluzion:** Nisur nga analiza e realizuar më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se, në institucionin e Kryeministrisë, janë përbushur të gjitha arsyet që çojnë në një proces ristrukturimi, pasi ndryshimi i strukturës dhe organikës së saj, ka sjellë jo vetëm reduktim të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, por edhe ndryshim në mënyrën e organizimit të tyre. Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me një ndryshim thelbësor të brendshëm të institucionit, me një proces riorganizimi si pasojë e pakësimit të vendeve të punës, ndryshimit të kriterëve të vendeve të punës dhe për këtë arsye kërkohet një rishpërndarje e burimeve njerëzore.

## II. Analiza e procesit të ristrukturimit

### 1. Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit

Procesi i ristrukturimit, fillon të materializohet me miratimin e strukturës së re të institucionit dhe në përbajtje të tij, përbëhet nga të gjitha aktet administrative që realizon njësia përgjegjëse gjatë implementimit të tij, që, në rastin konkret, janë aktet e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e transferimit të nëpunësve që u është ristrukturuar pozicioni i punës; si dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit.

Ky proces, është realizuar nga Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionin që po analizojmë.

Menjëherë pas miratimit të strukturës së re, Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit, me shkresën nr. 5350 prot., datë 11.10.2017, “*Mbi ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit*”, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit.

Në përmbushje të kërkesave të pikës 3, të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pikave 16 dhe 17 të Kreut II, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe pikës 1/1, 2 dhe shkronja a, të Kreut II, “*Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit*”, të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, njësi përgjegjëse (DAP), me aktin nr. 100/3, datë 12.10.2017, “*Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Kryeministrit*”, ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit, i cili ka në përbërje:

1. \*\*\*\*\*, Përgjegjës i Sektorit të Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Politikave të rekrutimit të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike – kryetar;
2. \*\*\*\*\*, Koordinator pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në Kryeministri – anëtar;  
(*Autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, në shkresën drejtuar DAP, pasi pozicioni i Drejtorit ka qenë i lirë*).
3. \*\*\*\*\*, Drejtor i Departamentit të Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri – anëtar.  
(*Autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm, në shkresën drejtuar DAP*)

**Konkluzion:** Konstatohet se ngritja dhe përbërja e Komisionit të Ristrukturimit është kryer sipas orientimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”.

## **2. Funksionimi i Komisionit të Ristrukturimit**

Komisioni i Ristrukturimit, në kuptim të ligjit, është organi kompetent për zhvillimin e procedimit administrativ në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit.



Menjëherë pas nxjerrjes së aktit të krijimit të tij nga njësia përgjegjëse, Komisioni i Ristrukturimit, ka marrë në shqyrtim mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese; më pas i ka propozuar njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin e nëpunësve në pozicionet e lira të të njëjtës kategori, në të cilën ata plotësojnë kërkesat specifike, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2, të nenit 50, të ligjit “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe ka vlerësuar dhe ka marrë vendim për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për arsytet e parashikuara në pikën 6, të nenit 50, të po këtij ligji.

Komisioni i Ristrukturimit, për marrjen e vendimit përfundimtar, punën e vet e ka bazuar në këto drejtime:

Së pari, ka krahasuar strukturën e re me strukturën ekzistuese dhe ka evidentuar njësitë e reja organizative që krijohen, suprimohen apo që ndryshojnë, si dhe pozicionet që preken nga ristrukturimi, ato që krijohen dhe ato që suprimohen.

Nga ky krahasim, siç është përmendur edhe më sipër në material, struktura ekzistuese kishte **133 pozicione** pune në shërbimin civil, prej të cilave **97 pozicione** ishin të plotësuara, ku 9 prej tyre, ishin pozicione të nivelit të lartë drejtues TND dhe **36 pozicione** ishin vende të lira, ndërsa struktura e re ka **78 pozicione** pune pjesë e shërbimit civil. Pra kemi reduktim të numrit të pozicioneve pjesë e shërbimit me **55 pozicione pune**.

Komisioni, evidentoi se përveç shkurtimeve të numrit të pozicioneve të punës, struktura e re ka sjellë ndryshime edhe në mënyrën e organizimit të saj, ku një pjesë e funksioneve të njësisë që janë shkurtuar, i kanë kaluar institucioneve të tjera që janë, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe institucioneve të varësisë si, Agjencia Telegrafike Shqiptare (ATSH) dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI).

Gjithashtu, Komisioni i Ristrukturimit evidentoi se, emërtesa, “*Inspektor*”, që i përkiste nivelit të mesëm drejtues, në strukturën e re, nuk ekziston.

Së dyti, Komisioni i Ristrukturimit, ka verifikuar përshkrimet e punës për pozicionet e krijuara, të mbetura apo të rristrukuara.

Rregullat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, miratimin dhe bërjen efektive të strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore, janë të përcaktuara në pikat nga 30 deri në 40, të vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”. Ndër të tjera këto rregulla parashikojnë se, përshkrimet e punës për çdo

pozicion pune të strukturës së re, i bashkëlidhen propozimit për ndryshimin e strukturës, që institucioni i dërgon DAP. Më konkretisht, në shkronjën “c”, të pikës 33, është parashikuar:

*“Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:*

.....

*(shkronja c) “Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi”. ...*

Detyrimin për hartimin e përshkrimeve të punës në momentin kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, e parashikon edhe vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar. Në mënyrë të shprehur pika 14, e kreut IV, të këtij akti nënligjor parashikon:

*“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit, apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.*

Në respektim të rregullave të vendosura nga aktet nënligjore si më sipër, subjektet e ngarkuara me përgjegjësinë e hartimit, miratimit e administrimit të përshkrimeve të punës siç janë: njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, analisti i punës, eprori direkt i pozicionit respektiv të punës, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe njësia përgjegjëse, duhet të hartonin përshkrime të reja pune, për të gjitha pozicionet e shërbimit civil të strukturës së re.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, fillimisht ka përgatitur një ekstrakt të përshkrimeve të punës, si dhe kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi për ndryshimin e organizimit të brendshëm të institucionit, të cilin, bashkë me relacionin propozues për ndryshimin e strukturës organike ia ka dërguar Departamentit të Administratës Publike. Më pas, këto materiale i janë vënë në dispozicion Komisionit të Ristrukturimit, i cili nga verifikimi i tyre ka evidentuar kriteret e veçanta për çdo pozicion pune të shërbimit civil. Komisioni në punën e tij, është asistuar nga njësia e personelit e institucionit, e cila ka kryer detyrat e Sekretarisë Teknike.

Pas marrjes së konfirmimit nga Departamenti i Administratës Publike, lidhur me propozimet për ripozicionimin e të gjithë punonjësve në strukturën e re, njësia e burimeve njerëzore, ka vazhduar procesin e finalizimit të përshkrimeve të reja të punës.

Në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion, u konstatua se, përshkrimet e punës, janë të hartuara sipas formatit që parashikon lidhja 4, bashkëlidhur vendimit nr.142, datë

12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, por, vetëm një pjesë e tyre janë miratuar nga nëpunësi civil përkatës, eprori direkt dhe nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në këtë rast, vlerësohet se kjo parregullsi është krijuar për rrethana objektive dhe nuk është e asaj natyre që të cenojë gjithë procesin për arsye se informacioni bazë për të realizuar procesin e ristrukturimit, i tillë si detyrat organike dhe kriteret e veçanta që kërkohen për çdo pozicion pune pjesë e shërbimit civil, rezulton se ishin përcaktuar përpara se procesi i ristrukturimit të fillonte. Por, kjo problematikë është evidentuar nga Komisioneri, në mënyrë që të përfundojnë përshkrimet e punës dhe në të ardhmen, aktorët që marrin pjesë në këtë proces, të përmirësojnë administrimin e shërbimit civil gjatë aplikimit të procesit e ristrukturimit.

**Së treti**, ka verifikuar dosjet personale të nëpunësve civilë, për të evidentuar përvojën në punë, arsimin dhe vlerësimin e arritjeve, duke aplikuar sistemin e vlerësimit me pikë, bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 1.3.2016, të DAP, të cilët janë elementët kyç mbi të cilën bazohet vendimmarrja.

Gjithashtu, ka verifikuar nëse ka nëpunës me probleme shëndetësore të vërtetuar me raport mjekësor, si dhe largësinë e vendbanimit me vendin e punës (më shumë se 45 km).

**Së katërti**, nga krahasimi dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur për nëpunësit civilë dhe informacionit për pozicionet e punës, ka vendosur për transferimin e përhershëm në pozicionet sipas strukturës së re, ose përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit, të cilat janë detajuar në vijim të materialit.

### **III. Transferime për shkak të ristrukturimit të institucionit**

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në zbatim të pikës 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me shkresën nr. 5554 prot., (në vazhdim fraksionet pasi aktet janë nominale), datë 14.9.2017, ka njoftuar të gjithë nëpunësit civilë, se, si rezultat i ristrukturimit të Kryeministrit, ata janë objekt i gjyqimit për transferimin apo përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

Komisioni i Ristrukturimit, në zbatim të pikave 1 dhe 2, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka parë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë, të përfshirë në ristrukturim.

Gjithashtu, për marrjen e vendimit përfundimtar të transferimit apo të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, Komisioni, është bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit

dhe Sistemin e Pikëzimit, që ka të bëjë me arsimin dhe përvojën në pozicionin aktual, në pozicione të ngjashme dhe në tërësi në shërbimin civil.

Pasi ka krijuar grupet e pozicioneve të punës brenda institucionit sipas kriterëve të veçanta, ka marrë në shqyrtim për të vlerësuar për transferim në këto pozicione, vetëm nëpunësit që plotësojnë kriteret.

Sa më sipër, Komisioni i Ristrukturimit, pasi vlerësoi mundësinë e transferimit të përhershëm të secilit prej nëpunësve civilë në pozicionet e reja të krijuara, me aktin nr.6787 prot., datë 1.12.2017, “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Kryeministritë*”, vendosi t’i propozojë Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, sistemin sipas pikës 2/a dhe 2/b, të nenit 50 të ligjit për nëpunësin civil, nëpërmjet transferimit të përhershëm të 54 nëpunësve civilë.

- ✓ Në **50 raste**, në pozicionet e reja të krijuara brenda Kryeministritë,
- ✓ Në **4 raste**, janë sistemuar nëpërmjet transferimit të përhershëm në institucionet që kanë marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi (*sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 50 të ligjit*).

Departamenti i Administratës Publike, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni i Ristrukturimit, me shkresën nr. 6787/1 prot., datë 1.12.2017, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë për shkak të ristrukturimit, për të gjitha rastet e propozuara nga Komisioni i Ristrukturimit dhe ka finalizuar procesin me nxjerrjen e aktit individual të transferimit, pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga secili nëpunës civil.

Duke i analizuar rast pas rasti këto transferime, konstatojmë:

A. Punonjës të sistemuar brenda strukturës së Kryeministritë

- 50 nëpunës civilë, janë sistemuar në pozicione të shërbimit civil, nëpërmjet transferimit të përhershëm, brenda institucionit të Kryeministritë.

Në këtë grup, vërejmë se:

- **49** nëpunës civilë, janë transferuar në të njëjtin nivel të klasifikimit në shërbimin civil dhe të njëjtën kategori page si para ristrukturimit.
- **1** nëpunës civil, është riemëruar po në nivelin ekzekutiv, por ka ndryshim të kategorisë së pagës, nga IV-a, në kategorinë III – b.

B. Punonjës të sistemuar në institucione të tjera

- 1 nëpunës civil, është sistemuar nëpërmjet transferimit të përhershëm në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në të njëjtin nivel dhe kategori page.

- **3 nëpunës civilë**, janë sistemuar nëpërmjet transferimit të përhershëm në Departamentin e Administratës Publike,
  - 2 prej të cilëve në të njëjtin nivel klasifikimi në shërbimin civil, pozicioni, “Specialist”, ndërsa,
  - 1 nëpunës ka pësuar ulje në kategori. Bëhet fjalë për nëpunësen, \*\*\*\*\*, e cila para ristrukturimit mbante pozicionin, “Drejtor” i Sekretariatit Teknik (Drejtoria) i Sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Administrimit Publik”, kategoria II-b dhe më pas, transferohet në pozicionin “Specialist”, Sektori i Qeverisjes së Mirë dhe Jetësisë të Prioriteteve, Departamenti i Administratës Publike”, kategoria III-b.

**III/1.** Në vijim, Komisioni i Ristrukturimit, në zbatim të pikës 2, shkronja “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka marrë në shqyrtim:

- ✓ *vendet e mbetura të lira në Kryeministri dhe kriteret për secilin pozicion,*
- ✓ *vendet e reja të krijuara në institucionet që kanë marrë funksionet e njësive organizative të Kryeministrisë,*
- ✓ *vendet e lira apo të krijuara të reja në institucionet e administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil, si dhe kriteret specifike për secilin pozicion,*
- ✓ *të dhënat e nëpunësve që nuk janë sistemuar akoma, vendet e të cilëve janë prekur nga ristrukturimi,*

Në përfundim të veprimeve administrative të kryera për verifikimin e kërkesave të posaçme të parashikuara për çdo pozicion të shërbimit civil si dhe verifikimit të të dhënave individuale të nëpunësve civilë në pritje për transferim, Komisioni i Ristrukturimit, nëpërmjet akteve nr. 6787/56 prot., datë 19.12.2017 dhe nr. 6787/67 prot., datë 12.1.2018, i ka propozuar Departamentit të Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, sistemimin nëpërmjet transferimit të përhershëm të 11 nëpunësve civilë, në ministritë e linjës dhe në institucionet vartëse të Kryeministrisë.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni i Ristrukturimit, ka nxjerrë aktet nominale të transferimit për secilin nëpunës.

Në këtë grupim konstatojmë se **8** nëpunës, janë sistemuar në të njëjtin nivel klasifikimi në shërbimin civil dhe kategori page dhe **3** nëpunës, kanë pësuar ulje në kategorinë e pagës. Emërimi në pozicionet e reja është bërë pas marrjes së pëlqimit paraprak të tyre.

Konkretisht:

- **5 nëpunës civilë**, të Drejtorisë së Informacionit, në Departamentin e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Qytetarët në Kryeministri, i cili suprimohet dhe funksioneti

kalojnë Drejtorisë së Monitorimit dhe Informacionit që i atashohet Agjencisë Telegrafike Shqiptare, sistemohen nëpërmjet transferimit të përhershëm në Drejtorinë e Monitorimit dhe Informacionit, në ATSH, në të njëjtin nivel në klasifikimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, si dhe të njëjtën kategori page.

- 2 nëpunës civilë, transferohen në Ministrinë e Drejtësisë, në të njëjtin nivel klasifikimi me shërbimin civil dhe kategori page.
- 2 nëpunës civilë, të Njësisë së Komunikimit Elektronik, Postar dhe Integritimit, janë transferuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, pasi me strukturën e re funksionet e kësaj njësie i kanë kaluar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Konstatohet se:

- **1** nëpunës civil, është transferuar në të njëjtën nivel dhe kategori page, ndërsa
  - **1** nëpunës, nga pozicioni, “*Koordinator*”, me kategori page III-a, është sistemuar në nivelin ekzekutiv, me kategori page, III-b. Emërimi është bërë me pëlqimin paraprak të tij.
- 2 nëpunës civilë, janë sistemuar nëpërmjet transferimit të përhershëm, në Institutin e Statistikave, në të njëjtin nivel, “*Specialist*”, por, ka ndryshuar kategorizimi i pagës, nga kategoria III – b, në kategorinë IV – b.

Koisioneri konstatoi se, në momentin e verifikimit, 2 nëpunës civilë, ende janë në proces shqyrtimi nga Komisioni i Ristrukturimit, përkatësisht:

- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin, “*Koordinator*”, ish Njësia e Monitorimit të Programeve (*leje lindje*),
- ✓ \*\*\*\*\* , në pozicionin, “*Specialist*”, ish Sektori i Informacionit (*i porsa kthyer nga pezullimi*).

#### **Nëpunësit e kategorisë së nivelit të lartë drejtues (anëtarë TND)**

- 7 nëpunës civilë në pozicione të nivelit të lartë drejtues, TND, janë emëruar nga DAP, sipas dispozitave të vendimit nr. 388, datë 6.5.2015, për emërimin e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues, ndërsa 2 nëpunës TND, janë në pritje të një emërimi të rregullt.

**Konkluzion:** Në përfundim të veprimeve administrative të kryera për verifikimin e kërkesave të posaçme të parashikuara për çdo pozicion të shërbimit civil si dhe verifikimit të

të dhënave individuale të nëpunësve civilë në pritje për transferim, Komisioni i Ristrukturimit, nëpërmjet vendimeve të marra prej tij, i ka propozuar Departamentit të Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për marrjen e vendimit përfundimtar, transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit në 65 raste.

- ✓ në 59 raste, nëpunësit janë sistemuar në pozicione të shërbimit civil të të njëjtës kategori;
- ✓ në 1 rast, nëpunës civil i kategorisë së mesme drejtuese është transferuar në pozicion të kategorisë ekzekutive, vendim të cilin e ka refuzuar dhe pas rivlerësimit është liruar nga shërbimi civil;
- ✓ në 5 raste, nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive kanë pësuar ndryshim në nivelin e kategorisë së pagës. Edhe në këtë rast, sistemimi është bërë me pëlqimin paraprak të tyre.

Referuar fakteve të përmendura më sipër, vlerësojmë se, dispozitat që rregullojnë institutin e ristrukturimit, në rastet kur për shkak ristrukturimi pozicioni i punës nuk ekziston më, apo nuk përmban karakteristikat e mëparshme, shprehen vetëm për detyrimin e njësisë përgjegjëse, për ruajtjen e kategorisë së pozicionit të punës, sipas konceptimit që i bën këtij elementi të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pika 2, e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Në këtë vështrim, në rastin e transferimit për shkak të ristrukturimit të pozicionit të punës, të një nëpunësi civil të kategorisë ekzekutive, sipas ligjit, ekziston detyrimi që pozicioni i ri i punës ku do të transferohet, të jetë gjithashtu pozicion i kategorisë ekzekutive, pa u lidhur me ndonjë detyrim të një natyre tjetër, si paga, kushtet e punës, etj.

Problemi i pagesës dhe niveleve të pagës, rregullohet nga neni 34, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Në pikën 2 të tij, përcaktohen përbërësit e pagës: “Paga e nëpunësit civil përbëhet nga paga bazë e kategorisë, shtesa për klasën së cilës i përket pozicioni, dhe shtesa për kushtet e punës” dhe në pikën 4, të po këtij neni, përcaktohet kompetenca e organit që përcakton strukturën dhe nivelin e pagës për çdo pozicion. Në ‘të thuhet shprehimisht: “Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave sipas këtij neni”, kompetencë e cila materializohet, për çdo rast dhe institucion, nëpërmjet urdhërave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave.

Ky është kuptimi që i jep ligji detyrimeve të institucionit për ruajtjen e statusit të nëpunësve civilë, në rastet kur pozicionet e tyre preken nga ristrukturimi. Nisur nga parimi kushtetues, i shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës, kuptohet që një nëpunës kur pranon të punojë në një pozicion pune të shërbimit civil, qoftë në momentin e pranimit në shërbimin civil, ashtu dhe në rastin e transferimit në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, për shkaqe

ligjore, është i detyruar të marrë parasysh që, do të paguhet sipas pagës së përcaktuar nga organi kompetent për atë pozicion pune. Organi kompetent për përcaktimin e pagës për pozicionet e punës është Këshilli i Ministrave, i cili nxjerr aktet e nevojshme nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave, të cilat siç u tha dhe më lart, materializohen nëpërmjet urdhrave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagës për çdo institucion dhe pozicion konkret pune.

Qëndrimin e mësipëm e ka mbështetur dhe gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në vendimin e saj nr. 80-2018-497, datë 15.2.2018, kur ka rrëzuar kërkesën e palës paditëse për ruajtjen e pagës së vendit të mëparshëm të punës, pavarësisht veprimit të drejtë të njësisë përgjegjëse, për ruajtjen e kategorisë së pozicionit të punës në një rast transferimi për shkak të shkurtimit të vendit të mëparshëm të punës. Në këtë vendim, gjykata arsyeton si më poshtë:

*“... Pala paditëse kundërshton vendimin e transferimit të saj për shkak se, në vendin e ri të punës i ka ndryshuar niveli i pagës nga III-b në IV-a. Në bazë të nenit 50 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, thuhet që kur për shkak të mbylljes ose të ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i punës së një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori ... .*

*Nga shqyrtimi i akteve të marrë në gjykim, rezulton se transferimi i palës paditëse është bërë në një pozicion të shërbimit civil brenda të njëjtës kategori, asaj ekzekutive, në përputhje me parashikimet e nenit 19 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*Ndryshimi i pagës në këtë rast, nga klasa III-b në IV-a, nuk i ndryshon palës paditëse kategorinë, pasi të dyja këto kategori pagash i përkasin kategorisë ekzekutive, specialist.*

*Për sa më sipër, pretendimi i palës paditëse se transferimi i saj është bërë në kundërshtim me parashikimet e nenit 50/1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është e pabazuar në ligj e në prova. Gjithashtu dhe pretendimi i saj për kundërshtpërblimin për dëmin e krijuar nga ulja e pagës dhe dëmi moral, është i pabazuar në ligj dhe në prova.....” .*

### **III/2. Transferimi i nëpunësve civilë, për shkak të ristrukturimit, në institucione jashtë shërbimit civil.**

Me miratimin e strukturës së re të Kryeministrit, vërehet se nuk ka asnjë strukturë organizative të dedikuar për realizimin e funksioneve të menaxhimit TIK dhe se funksionet e Drejtorisë së IT, do të kryhen nga njësitë organizative në përbërje të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI).

Në këto kushte, Komisioni i Ristrukturimit, në zbatim të pikës 2/b, të nenit 50, të ligjit për nëpunësin civil, ku citohet se, në rast ristrukturimi të institucionit nëpunësi civil, *transferohet në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi, nëpunësit*



civilë të kësaj Drejtorie, duhet të transferohen në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, (AKSHI).

Meqenëse marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKSH-t, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësit e Drejtorisë së IT në Kryeministri,

- ✓ \*\*\*\*\* – Koordinator në Departamentin e Inovacionit dhe Mirëqeverisjes, me vendimin nr. 6496, datë 20.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ \*\*\*\*\* – Specialist në Drejtorinë e IT, në Departamentin e Administrimit dhe Shërbimeve, me vendimin nr. 6495, datë 20.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.
- ✓ \*\*\*\*\* – Specialist në Drejtorinë e IT, në Departamentin e Administrimit dhe Shërbimeve, me vendimin nr. 6494, datë 20.12.2017, të Komisionit të Ristrukturimit, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil.

Më tej, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ka nxjerrë aktin për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit e lartpërmendur duke njoftuar nëpunësit për vendimmarrjen dhe njëkohësisht DAP – in, si njësia përgjegjëse.

Bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku parashikohet se nëpunësit civil që i përfundon marrëdhënia në shërbimin civil si pasojë e ristrukturimit të institucionit, “*ka të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë*”, institucioni, ka nxjerrë aktin e dëmshpërblimit për secilin nëpunës.

Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 7175 prot., datë 20.12.2017, ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, fillimin e procedurave për vijimin e punësimit të këtyre punonjësve.

#### **IV. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit**

Sikundër është përmendur edhe më sipër në material, struktura e re e Kryeministrisë ka sjellë shkurtim të numrit të pozicioneve të punës.

Për të parë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë, për shkak të ristrukturimit, Komisioni, ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e nevojshëm për gjithë nëpunësit që janë objekt i ristrukturimit.

Bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 50 të ligjit për nëpunësin civil, Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka bërë vlerësimin e gjithë dokumentacionit të nevojshëm si:

- Strukturën dhe organikën e Kryeministritë para dhe pas ristrukturimit,
- Të dhënat individuale të nëpunësve civilë që janë prekur nga ristrukturimi, (që nuk janë sistemuar akoma)
- Kriteret specifike të vendeve të lira ekzistuese apo të krijuara si pasojë e ristrukturimit brenda Kryeministritë,
- Kriteret specifike të pozicioneve të reja apo të lira në shërbimin civil dhe përshkrimet e punës të këtyre pozicioneve, në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të administratës shtetërore, sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike,

arriti në përfundimin se, për 3 nëpunës civilë, nuk gjeti mundësinë e sistemimit.

Konkretisht, po analizojmë rast pas rasti nëpunësit që janë liruar nga shërbimi civil.

- \*\*\*\*\* , me strukturën ekzistuese, mbante pozicionin e punës, “*Koordinator*”, në *Sekretariatit Teknik (Drejtoria) i Sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Administrimit Publik*”, në *Departamentin e Inovacionit dhe Mirëqeverisjes*, pozicioni i nivelit të mesëm drejtues. Kjo njësi, me strukturën e re të institucionit, është suprimuar.

Komisioni i Ristrukturimit, ka marrë në shqyrtim pozicionet e kategorisë së mesme drejtuese, të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe kriteret specifike të tyre, dosjen individuale të nëpunëses, nivelin arsimor dhe përvojën në punë për të parë mundësinë e sistemimit të saj.

Nga kjo analizë, rezultoi se transferimi i nëpunëses, në një pozicion të lirë të të njëjtës kategori, në të cilën ajo plotëson kriteret specifike brenda institucionit, është i pamundur.

Gjithashtu, Komisioni, duke bërë krahasimin me kriteret që plotëson nëpunësja civile në fjalë dhe përshkrimin e pozicionit të punës ekzistues, me të dhënat e vëna në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike, për kriteret e vendeve të lira në shërbimin civil, në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të administratës shtetërore, si dhe përshkrimet e punës të pozicioneve të reja apo të lira, vërejtë se transferimi i nëpunëses \*\*\*\*\* , në një pozicion pune të të njëjtit nivel dhe kategori page, (niveli i mesëm drejtues), është i pamundur.

Si përfundim, Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, vendosi deklarin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen \*\*\*\*\* , në pozicionin “*Koordinator*”,

në Sekretariatit Teknik (Drejtoria) i Sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Administrimit Publik”, në Departamentin e Inovacionit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri; si dhe dëmshpërblimin në përputhje me vjetërsinë e saj në punë, sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Institucioni, me shkresën nr. 6497/2 prot., datë 26.12.2017, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të \*\*\*\*\*”, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, si dhe nëpunësen, për vendimin e marrë nga Komisioni i Ristrukturimit.

- \*\*\*\*\* , me strukturën ekzistuese, mbante pozicionin e punës, “Specialist”, në Njësinë e Monitorimit të Legjislacionit dhe Programeve, në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit, pozicioni i nivelit ekzekutiv. Kjo njësi, me strukturën e re të institucionit, është suprimuar.

Komisioni i Ristrukturimit, ka marrë në shqyrtim pozicionet e kategorisë ekzekutive, të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe kriteret specifike të tyre, dosjen individuale të nëpunësit, nivelin arsimor dhe përvojën në punë, për të parë mundësinë e sistemimit të tij.

Nga kjo analizë, rezultoi se transferimi i nëpunësit, në një pozicion të lirë të të njëjtës kategori, në të cilën ai plotëson kriteret specifike, brenda institucionit, është i pamundur.

Më tej, Komisioni, pasi ka bërë krahasimin e kriterëve që plotëson nëpunësi civil në fjalë dhe përshkrimin e pozicionit të punës ekzistues, me të dhënat e vëna në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike, për kriteret e vendeve të lira në shërbimin civil, në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të administratës shtetërore, si dhe përshkrimet e punës të pozicioneve të reja apo të lira, vërejtji që transferimi i nëpunësit \*\*\*\*\* , në një pozicion pune të të njëjtit nivel dhe kategori page, (niveli ekzekutiv), është i pamundur.

Si përfundim , Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendosi deklarin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësin \*\*\*\*\* , në pozicionin, “Specialist”, në Njësinë e Monitorimit të Legjislacionit dhe Programeve, në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri, si dhe dëmshpërblimin në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Institucioni, me shkresën nr.6499/2 prot., datë 26.12.2017, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të \*\*\*\*\*”, ka njoftuar Departamentin e Administratës

Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, si dhe nëpunësin, për vendimin e marrë nga Komisioni i Ristrukturimit.

- \*\*\*\*\* , me strukturën ekzistuese, mbante pozicionin e punës, “*Specialist*”, në Njësinë e Legjislacionit dhe Akteve të Këshillit të Ministrave, në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri, pozicioni i nivelit ekzekutiv. Me strukturën e re të institucionit, pozicioni specialist në këtë njësi, është suprimuar.

Komisioni i Ristrukturimit, ka marrë në shqyrtim pozicionet e kategorisë ekzekutive, të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe kriteret specifike të tyre, dosjen individuale të nëpunëses, nivelin arsimor dhe përvojën në punë për të parë mundësinë e sistemimit të saj.

Nga kjo analizë, rezultoi se transferimi i nëpunëses, në një pozicion të lirë të të njëjtës kategori, në të cilën ajo plotëson kriteret specifike, brenda institucionit, është i pamundur.

Më tej, Komisioni, pasi ka bërë krahasimin e kriterëve që plotëson nëpunësja civile në fjalë dhe përshkrimin e pozicionit të punës ekzistues, me të dhënat e vëna në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike, për kriteret e vendeve të lira në shërbimin civil, në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera të administratës shtetërore, si dhe përshkrimet e punës të pozicioneve të reja apo të lira, vërejtji që transferimi i nëpunëses \*\*\*\*\* , në një pozicion pune të të njëjtit nivel dhe kategori page, (niveli ekzekutiv), është i pamundur.

Si përfundim , Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, vendosi deklarin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen \*\*\*\*\* , në pozicionin “*Specialist*”, në Njësinë e Legjislacionit dhe Akteve të Këshillit të Ministrave, në Departamentin e Legjislacionit, Monitorimit të Programeve dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri, si dhe dëmshpërblimin në përputhje me vjetërsinë e saj në punë, sipas pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Institucioni, me shkresën nr. 6498/1 prot., datë 26.12.2017, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të \*\*\*\*\*”, të Sekretarit të Përgjithshëm, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, si dhe nëpunësen, për vendimin e marrë nga Komisioni i Ristrukturimit.

## **V. Raste të refuzimit të vendimit të transferimit**

Komisioni i Ristrukturimit, si kundër jemi shprehur edhe më sipër në material, në përfundim të verifikimeve të kryera për transferimin e nëpunësve civilë të prekur nga ristrukturimi, ka

vendosur transferimin e nëpunëses civile \*\*\*\*\* , në një pozicion tjetër në shërbimin civil.

Në momentin e ristrukturimit, nëpunësja mbante pozicionin, *“Drejtor” i Sekretariatit Teknik (Drejtoria) i Sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Administrimit Publik*”, në Departamentin e Inovacionit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri, kategoria II-b dhe është transferuar në pozicionin *“Specialist”, Sektori i Qeverisjes së Mirë dhe Jetësimit të Prioriteteve, Departamenti i Administratës Publike*”, kategoria III-b, në Departamentin e Administratës Publike.

Ky transferim është kushtëzuar nga suprimimi i Departamentit të Inovacionit dhe Mirëqeverisjes, ku nëpunësja civile ishte e emëruar, si dhe nga fakti që funksionet e kësaj njësie i kanë kaluar Sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Jetësimit të Prioriteteve, në DAP.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me shkresën nr.6787/55prot., datë 1.12.2017, *“Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”*, ka njoftuar nëpunësen \*\*\*\*\* , për transferimin në pozicionin e ri të punës, të cituar më lart.

Në zbatim të pikës 20, të Kreut II, *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, të vendimit nr. 125, datë 17.12.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, DAP, para se të miratojë transferimin, ka kërkuar pëlqimin me shkrim të nëpunëses \*\*\*\*\* , për pozicionin e ri të punës.

Nëpunësja, bazuar në pikën 20, të Kreut II, të Vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë”*, e ka kundërshtuar këtë emërim.

Sipas nëpunëses, propozimi i Komisionit të Ristrukturimit, për transferimin në pozicionin Specialist, në DAP, me kategori III-b, është i paligjshëm dhe në mospërputhje me nenin 50 të ligjit për nëpunësin civil.

Për sa më sipër, nëpunësja, nuk është shprehur dakord me vendimin e transferimit dhe ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike të rishikojë këtë vendim.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, verifikoi shkaqet e refuzimit të transferimit të pretenduara nga nëpunësja, dhe pas vlerësimit të dosjes personale dhe kriterëve të posaçme të pozicioneve të lira apo të krijuara të reja, ka vendosur anulimin e aktit nr. 6787/55 prot., datë 1.12.2017, të DAP dhe kthimin e akteve për rishqyrtim Komisionit të Ristrukturimit të Kryeministrit.

Komisioni i Ristrukturimit, bëri rivlerësimin e gjithë dokumentacionit të nevojshëm dhe verifikoi mundësinë për transferimin e nëpunëses në një pozicion tjetër të shërbimit civil të

të njëjtës kategori, në të cilin plotëson kriteret e veçanta dhe ka përshkrim të njëjtë ose të ngjajshëm për nga funksionet që ka kryer nëpunësja, deri në pozicionin e fundit.

Pasi shteroi mundësinë e transferimit, bazuar në pikën 6 të nenit 50 të ligjit për nëpunësin civil, Komisioni i Ristrukturimit të Kryeministrit, me vendimin nr. 471 prot., datë 26.1.2018, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për \*\*\*\*\**”, vendosi deklarinimin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen \*\*\*\*\*, në pozicionin, “*Drejtor i Sekretariatit Teknik (Drejtoria) i Sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Administrimit Publik*”, në Departamentin e Inovacionit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri, si dhe dëmshpërblimin në përputhje me vjetërsinë e saj në punë, sipas pikës 7 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Me shkresën nr. 471/1 prot., datë 27.1.2018, të Drejtorit të Departamentit të Burimeve, Transparencës dhe Administrimit, në Kryeministri, nëpunëses i është komunikuar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit dhe suprimimit të pozicionit të punës.

Për këtë vendimmarrje të Komisionit të Ristrukturimit, institucioni, ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike, si njësia përgjegjëse për menaxhimin e shërbimit civil.

## **VI. Rastet e nëpunësve civilë, që nuk janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i Ristrukturimit. (Raste të pezullimit nga shërbimi civil dhe dorëheqje).**

### ***a) Pezullimi***

Bazuar në nenet 53,54 dhe 55, Kreu IX, “*Pezullimi nga shërbimi civil*”, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, 13 nëpunës civilë, kanë kërkuar pezullimin nga shërbimi civil.

Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në pikën 2 të nenit 53 të ligjit për nëpunësin civil, ku shprehimisht citohet se *gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me nismën e nëpunësit të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht nga ky ligj*, për këta nëpunës, nuk është shprehur, pasi nuk ishin objekt shqyrtimi.

Marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil, për këta nëpunës civilë, do të merret në shqyrtim në momentin kur përfundon periudha e pezullimit.

## ***b) Dorëheqja***

Komisioni i Ristrukturimit, 2 nëpunës civilë, nuk i ka marrë në shqyrtim dhe nuk është shprehur për marrëdhënien e tyre të punësimit, pasi nëpunësit, bazuar në nenin 64, “*Dorëheqja*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, kanë kërkuar dhe më pas i është miratuar dorëheqja nga shërbimi civil.

## **VII. Respektimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike**

Një moment tjetër i mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit të aplikuar pranë Kryeministrisë, është verifikimi i afateve të përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Si rregull, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, *në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit*, njofton individualisht nëpunësit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. *Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t’u përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit.* (*pika 15 e kreut II, të VKM nr. 125, dt. 17.2.2016*). Rezulton se ky afat është respektuar nga Departamenti i Administratës Publike.

Më tej, është parashikuar se, nëpunësi më i lartë civil i institucionit në ristrukturim, jo më vonë se *2 ditë* pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar ristrukturimin, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit. Njësia përgjegjëse (DAP), brenda *2 ditëve* nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit (*sipas përcaktimeve të pikave 1, 1/1 e 2, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike*).

Pasi krijohet nga njësia përgjegjëse, Komisioni Ristrukturimit brenda *15 ditëve*, nga momenti i krijimit të tij, i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), vendimet mbi transferimin e nëpunësve civil (*sipas përcaktimeve të pikës 16, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike*).

Në vazhdim, njësia përgjegjëse, brenda *10 ditëve*, nga data e marrjes së propozimit për transferimin e nëpunësve civil nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për miratimin e propozimeve në fjalë, ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërteton parregullsi ligjore, i cili e rishqyrton brenda 5 ditëve (*sipas pikës 20, Kreu II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 18, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP*).

Në këtë rast, aktet nënligjore kanë parashikuar edhe njoftimin e vendimit të transferimit nëpunësit civil që transferohet dhe marrjen e mendimit të tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit; të drejtën e nëpunësit që të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse brenda 5 ditëve dhe pas kësaj rikthimin e akteve për rivlerësim Komisionit, i cili duhet të japë mendimin e tij brenda 5 ditëve (*sipas pikës 20 e 21 të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 19, 20 e 21 të udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP*).

Në këto rrethana, nëse do të aplikoheshin të gjitha fazat e procesit të ristrukturimit, si dhe afatet procedurale të ankimit, si dhe duke llogaritur vonesat në marrjen e njoftimit nga subjektet e përcaktuara në aktet rregullative të përmendura më sipër, atëherë i gjithë ky proces parashikohet që të kryhet brenda një afati kohor që zgjat rreth 60 ditë kalendarike.

Referuar bazës ligjore si më sipër, rezulton se gjatë kryerjes së veprimeve administrative në kuadër të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, duhet të respektohen edhe afatet procedurale të parashikuara për këtë rast.

Për sa është parashtruar në përmbajtje të këtij relacioni, rezulton se, procedura e shqyrtimit të mundësisë së sistemimit të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit të Kryeministrisë, është kryer në disa faza, të cilat janë materializuar në vendimet respektive të Komisionit të Ristrukturimit dhe Departamentit të Administratës Publike.

Nga verifikimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit rezulton, se nga momenti i miratimit të aktit që ka miratuar strukturën e re, konkretisht data 10.10.2017 (*duhet përmendur fakti që struktura e re i shtrin efektet në datën 1.11.2017 dhe Komisioni ka filluar të veprojë në këtë datë*) dhe ngritja e Komisionit të Ristrukturimit në datën 12.10.2017, faza e parë e procedurës së ristrukturimit që ka të bëjë me sistemimin e nëpunësve brenda institucionit, ka përfunduar në datën 1.12.2017. Sipas dokumentacionit përkatës, rezulton se faza e dytë ka përfunduar në datë 12.1.2018 dhe faza e tretë ka përfunduar në datën 19.1.2018. (*sistemimi i nëpunësve nëpërmjet transferimit në ministritë e linjës, institucionet e varësisë si dhe lirimi nga shërbimi civil si rezultat i ristrukturimit*).

I gjithë procesi i ristrukturimit ka përfunduar në datën 26.1.2018, me vendimin e Komisionit të Ristrukturimit, për lirim nga shërbimi civil të nëpunëses \*\*\*\*\*\*, pas rivlerësimit të dosjes individuale të saj. (Në tërësi procedura është realizuar pothuajse për 60 ditë).

Në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e ristrukturimit, ligjvënësi ka përcaktuar të vendosë afatet procedurale të përmendura më sipër, për të disiplinuar këtë proces me qëllim që procesi të mos zvarritet. Megjithatë, vlen të theksohet se, afati i mësipërm ligjor shërben si një garant në kushtet e zhvillimit të një procesi ristrukturimi në rrethana të zakonshme. Në rastin konkret, për sa është pasqyruar në përmbajtje të këtij raporti, rezulton se ndodhemi në kushtet e riorganizimit tërësor të aparatit shtetëror, i cili është shoqëruar me ndryshim të



theksuar të mënyrës së funksionimit të ministrive dhe Kryeministrit, misionit të tyre si dhe të riformatimit të njësisë organizative, fakt që kërkon një periudhë më të gjatë kohore të realizimit të procedurës së ristrukturimit.

Komisioneri vlerëson se, në rastin e Kryeministrit, ky tejkalim prej disa ditësh, në afatet e caktuara në udhëzimin e DAP, ka ardhur si rrjedhojë e numrit të lartë të nëpunësve civilë, pozicionet e të cilëve prekeshin me miratimin e strukturës dhe organikës së re të këtij institucioni, si dhe për shkak të ushtrimit të kompetencave ligjore të Departamentit të Administratës Publike për verifikimin e zbatimit të legjislacionit civil gjatë vendimmarrjes së Komisionit të Ristrukturimit, me qëllim garantimin e të drejtave të nëpunësve civilë nëpërmjet një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në rastin konkret Komisioneri vlerëson se, aplikimi i procesit të ristrukturimit nga aktorët e caktuar nga ligji është realizuar brenda afateve ligjore, duke përmbyllur këtë proces pa zvarritje.

Nga sa sipër, arrijmë në përfundimin se procedimi administrativ i Komisionit të Ristrukturimit të Kryeministrit, me qëllim sistemimin e nëpunësve civilë në pozicionet e lira apo të krijuara të reja pas ristrukturimit, nga pikëpamja procedurale, janë kryer në përputhje me ligjin.

**Konkluzion:** Nga sa analizuam, nisur nga përmbajtja e akteve ligjore e nënligjore, në të cilat materializohet procedura e sistemimit të nëpunësve civilë pas procesit të ristrukturimit të Kryeministrit, provohet se, nga pikëpamja procedurale, janë respektuar të gjitha kërkesat e nenit 50, të ligjit nr.152/ 2013, i ndryshuar, vendimit nr.125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Kreu II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, nga momenti i ngritjes së komisionit të ristrukturimit, funksionimit të tij, transferimit të nëpunësve civilë, si dhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që ishte i pamundur sistemimi i tyre.

## VIII. Detyrat e lëna dhe Rekomandimet

Në përfundim të procesit të monitorimit lidhur me veprimet administrative që janë kryer në kuadër të ristrukturimit të Kryeministrit, Komisioneri vlerëson se nga ana e institucionit duhet të kryhen këto detyra:

- ✓ Njësia e burimeve njerëzore e institucionit bashkëpunim me njësinë përgjegjëse DAP, të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, sipas rregullave dhe procedurave të

përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar dhe lidhjeve pjesë e këtij vendimi.

\*

\* \*

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të monitorimit të procedurave të kryera në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Kryeministrit, në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe njësia përgjegjëse, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri në këtë Raport, për të finalizuar sa më shpejt procesin e hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës, me qëllim përmirësimin e situatës në administrimin e shërbimit civil në institucionin e monitoruar.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**